

N

JESIA ADM. SELITË

ADMINISTRATOR : PJETER PEPKOLAJ (PS)

TERRITORI

Sipërfaqja : 101.1 km²

Përbëhet nga një qytet e 8 fshatra :Lufaj, Bardhaj, Lekunde, Zajs, Kthellë e Epër, Kurbnesh-Fshat, Merkurth, Kumbull.

Qendra e Nj. Adm. është qyteti Kurbnesh

DEMOGRAFIA

Popullsia (Janar 2012): 1974 banorë

Dendësia : 20 banorë/km²

Familje : 536

Në qytet : 68

Në fshat : 468

Nj. ADM. e Selitës shtrihet në Juglindje të rrethit të Mirditës. Kurbneshi është i njohur si një vendburim bakri. Në këtë qytet ka pasur edhe një fabrikë të përpunimit të bakrit, e cila tashmë nuk funksionon. Zona është e pasur me ujra të ftohtë e kurativ si dhe ka 4 monumente natyrore. Ka një reliev malor, me pyje e kullota të pasura.

Në mes të malit të Didhes e të Kunorës ndodhet një burim uji që njihet me emrin: Kroi i Bardhë. Ujëti e Kroit të Bardhë ka vlera të rralla kurative, pasi ndikon në shërimin e disa sëmundjeve, si atyre të rrugëve urinare, laringut, stomakut, veshkave, tiroideve etj. Tërheqës është dhe mjedisi turistik e ekologjik i kësaj pike turistike të Selitës. Kroi i Bardhë frekuentohet prej më se 25 vjetësh nga vizitorë, pushues të shumtë, të sëmurë gjatë muajve të verës, megjithëse ende nuk ka kushte dhe infrastrukturë të përshtatshme. Gjithnjë është folur për rëndësinë e një investimi në këtë pikë turistike të rrallë, që nënkupton ndonjë kamping, hotel e mjedise të tjera për frekuentuesit, por deri sot nuk është realizuar diçka e tillë.

Vendburimi i Kroit të Bardhë është 1350 m mbi nivelin e detit, me prurje 18 litra/min dhe temperaturë 3-4°. Uji kalon midis shkëmbinjëve ultrabazikë, duke përfituar përmbajtje mineralogjike të larmishme që veprojnë në organizmin e njeriut. Ndodhet 55 km në lindje të Rrëshenit.